

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1001 Prot.

Tiranë, më 27.09 2016

VENDIM Nr. 95, datë 14.09.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11 të datës 14.09.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të **projektit "Resort dhe fshat turistik "Gone Perivol", në zonën e quajtur Drimadhe (Perivolo)-subjekti "Concord Investment"**, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të **projektit "Resort dhe fshat turistik "Gone Perivol", në zonën e quajtur Drimadhe (Perivolo)-subjekti "Concord Investment"**, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova.
2. Shoqëria **"Concord Investment"** duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për ndërtimin e **"Resort dhe fshat turistik "Gone Perivol", në zonën e quajtur Drimadhe (Perivolo)**, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO-FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO